



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e pesëmbëdhjeta e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.05.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdije Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajci Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të, monitoruesja nga DEMOS - KDI, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt – Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (SHPMPPF).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 4-110 zona kadastrale Carrallukë.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 13-1 zona kadastrale Carrallukë.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 692-0 kadastrale Istog.
7. Shpallja në diskutim publik e Draft – Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut.
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Fjolla Ukaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, pa, se në rend të ditës kemi disa pka për shpallje në interes publik zona të ndryshme parcela të komunës me këtë rast propozoj parcelën zona kadastrale Orrobert kullos e cila ka sipërfaqe prej 25 ari e 5 metra si dhe parcela tjetër me 1 hektar e 69 ari e 20metra, kete zon e propozoj për klubin Onix i cili garon në ligen e dytë ndërsa stërvitjet i kryejnë here në Novosell e here në Vitemerik ku është një ngarkesë për ta si për familjen të cilat e bëjnë transportin e fëmijëve si dhe për klubin. Ky klub mbijeton fal familjes Ferati dhe një donatori i cili është nga Gjermania. Prandaj në të mirë të klubit dhe fëmijëve tan propozoj që kjo pik të hy si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit – se di a mund të hy kjo pik tash sepse nuk është e përgatitur.

Drejtori për Kadaster dhe Gjodezi, z. Agon Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron rreth pikse së propozuar dhe procedurave që janë duke u zhvilluar.

Fjola Ukaj - pasi që kjo pronë nuk paska nevojë me u shpall zonë me interes publik propozoj që të hy në rend dite.

Nuk është hera e par është e disata here që unë e propozoj këtë pike dhe as një here nuk kam marr as një përgjigje. Kam pasur kontakt me ta dhe kjo pjese është interes e kësaj shkolle të futbollit, kërkoj që të hyn si pik e rendit të ditës e drejt e juaja është a e shti a jo kjo është kërkesa ime.

Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, edhe ne e mbështesim propozimin e Fjollës sepse është kërkesë e drejt dhe ka të drejt me e propozuar një pik te rendit te ditës, fjolla e ka propozuar mirë shume këtu e ka mor edhe planin që tregohet qe e ka mor edhe kush është poseduesi i saj i ka certifikatat pronësorë të dhënat e nevojshme. Mundet Fjolla me ja jep sekretarisë se Kuvendit këto letra me i bë kopje dhe me na i shpërnda këtu. Mendoj që kjo është pikë e rëndësishme sepse ka të beje me shkollë të futbollit dhe as një fshat nuk ka që kemi ne fushë që mund të merremi me sport, prandaj mendoj që nuk është e drejt që me jua hup të drejtën e një asambleisti me e propozuar një pik për rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit - çështja e pronave pa kaluar neper Komitetin për politikë e Financa nuk mund të procedohet direkt në kuvend. Nuk është askush kundër propozimit të Fjollës, ekzekutivi e përgatit për muajin e ardhshëm.

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, është mirë mos me kaluar si pik se shumë pika po kalojnë kështu hajt se binë, të hinë si pik e rendit të ditës shqyrtimi me debatuar për këtë temë edhe me e len një mundësi që në seancën tjetër me ardh kjo pik edhe në miratim. Ne ligjin asgjë nuk e thejmi nëse flasim për një temë të caktuar. Këtu po shihet qartë se klubi e ka shprehur interesin e vet po donë në atë parcel nuk kemi nevojë me shkuar në prona të AKP-së pasi që kemi prona komunale vendimi është i veçantë. Si shqyrtim mund ta shtiesh debatojmë për të mundemi me diskutuar.

Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, ne jemi duke biseduar sot për dy prona të fshatit Cerrolluk njëren e menaxhon AKP-ja ndërsa tjetra pronë komunale, siç e kuptova drejtorin ne këtë pronë nga AKP-ja po mundohemi ta marrim për këtë klub. Kjo prona e AKP është vendi me i përshtatshëm dhe ka hapsin me shumë për shkollën e futbollit, bisedoni me klubin që donë ata pronën komunale as një nga asamblist nuk është kundër.

Drejtori për Kadaster dhe Gjodezi, z. Agon Dreshaj - mu duket se u keqkuptova nga Nimani dhe Agroni, parcela komunale nuk ka nevojë me u shpall zonë me interes publik (shpjegon procedurat për dhënien ne shfrytëzim) por prona e AKP-së për investitorin është me e favorshme.

Agron Gashi - qëllimi im është vetëm te hyn në procesverbal dhe tija fillojmë me procedurat, kemi disa prona qe po kërkohe dhe nuk po hyn në rend dite, Fjolla ka kërkuar për këtë pronë disa hete që të hy në pik të rendit të ditës. Ne jemi që ti ngutim proceset sepse investitorët nuk presin.

Hajrush Shoshi - investitorët të diskutojnë me kryetarin dhe se cila pronë është me e favorshme dhe ty jepet prona.

Fjolla Ukaj - unë as klubi nuk kemi njohuri nëse kjo pronë është e shpallur nga komuna dhe mund të aplikoj kush donë për atë pronë

Niman Beqiraj - të hy kjo pikë në rend dite dhe të diskutojmë për pronën në fshatin Orrobeerd.

Kryesuesi i Kuvendit - hedhe në votim, piken e rendit të ditës që të diskutohet Miratohet me 23 vota për , 2 abstenime.

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, LVV kërkojmë që pikat sipas planit të punës të hin në rend dite pikat të cilat i keni hekur ju arbitrarisht, të muajit prill diskutim rreth pronave bujqësore që janë të uzurpuara dhe për prona të paluajtshme të komunës banesa e lokale afariste dhe për ato që e dimë që janë të uzurpuara dhe ju prape nuk keni pranuar, që për këtë temë diskutuam gjysme ore shumë me shpejt do të përfundoj pasi që të debatohet folët 5 minuta dhe përfundon.

Kryesuesi i Kuvendit - këtu jam duke e zbatuar ligjin Statutin e komunë, Rregulloret, po ashtu edhe Kodin e Etikës.

Hedh në votim rendin e ditës
Miratohet unanim rendi i ditës për këtë mbledhje.
Konstatohet që me 23 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit - në mbledhje mungojnë: Ajshe Metaj, nuk ka lajmëruar që nuk mund të vijë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit - Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Pasi q nuk keni diçka,

Hedh në miratim

Miratohet unanim

Konstatohet që me 21 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 30.05.2023 pa vërejtje.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (SHPMPPF).

Drejtoresha për Mirëqene Socialë – Merita Bytyçi - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Projekt - Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Punës në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (SHPMPPF).

Lavdiqe Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që kuzhina e shtëpisë së pleqve të ndryshohet vendi sepse është i pa përshtatshëm për pleqtë.

Haki Podrimaj – propozon, neni 3 paragrafi 4 të sqarohet (mes dy vakteve) të neni 3 shtohet të angazhohet edhe një dietolog. neni 7 paragrafi 2 të sqarohet paragrafi, Të neni 23 të shtohet psikologu dhe psikiatri. Të neni 28 paragrafi 4 të sqarohet paragrafi.

Hajrush Shoshi – neni 40 të përmirësohet teknikisht.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush te shtoj diçka rreth këtij raporti. Pasi që nuk ka diskutime tjera.

Hedh në miratim,

Miratohet unanim.

24 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 4-110 zona kadastrale Carrallukë.

Drejtor për Kadastër dhe Gjodezi -z. Agon Dreshaj, benë prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 4-110 zona kadastrale Carrallukë

Kryesuese i Kuvendit - a ka dikush diçka,

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit.

Të pranishëm 23 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës, Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 13-1 zona kadastrale Carrallukë.

Drejtor për Kadastër dhe Gjodezi -z. Agon Dreshaj, benë prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 13-1 zona kadastrale Carrallukë

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?
Pasi që diskutime tjera nuk ka
Hedh në votim
Miratohet unanim
Konstatohet që 23 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me Nr. 692-0 zona kadastrale Istog.

Drejtor për Kadastër dhe Gjodezi -z. Agon Dreshaj, benë prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për shpalljen në interes publik të njësisë kadastrale me 692-0 zona kadastrale Istog.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka rreth këtij plani
Pasi që diskutime nuk ka
Hedh në votim
Miratohet unanim
Konstatohet që 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër, Shpallja në diskutim publik e Draft - Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, Draft - Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut.

- Pas shumë debatesh dhe diskutime nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit - **Hedh në votim**
Miratohet unanim
Konstatohet që 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër, të propozuar nga anëtarja e kuvendit Fjolla Ukaj. Debat rreth pronës komunale në fshatin Orroberd mbrapa postes.
Kush dëshiron të diskutoj rreth kësaj çështje?
Pasi askush nuk e dëshiron fjalën!
Kalojmë në piken e fundit për këtë mbledhje.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Valbone Demaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, kërkesa nga drejtorja e arsimit e dimë që mungesa e kopshteve, po thuhet të gjitha grat janë të punësuara dhe nuk po kanë ku ti len fëmijët. Pasi që çerdhja e re është duke u ndërtuar kam kërkesa që në atë objekt me u nda një ose dy dhoma qendra ditore me orar me të gjate pasi që grat punojnë nëpër qendra tregtare dhe kanë orarin me të zgjatuar ne e kemi një qendër ditore por është private dhe po kushton shtejt, sa mundeni ju drejtor me na ndihmuar në kërkesën që ne kemi.

Kërkesa tjetër disa gra që veprojnë në komunën tonë blegtore për shkak të shkollimit ato nuk po mund të aplikojnë për subvencionime, si mund të ja mundësojmë atyre grave që ta përfundojnë shkollën fillore.

Agron Gashi – kam një pyetje për nënkryetarin, nëse ka mundësi me na jep ndonjë afat se kur do të përfundojnë këto rrugët e qendrës?

Niman Beqiraj - kam tri pyetje, deri të kjo pyetje kam ardhur nga kërkesat e shumta të prindërve, edhe rasti i fundit që ka ndodhur në shkollën fillore në fshatin Vrellë rreth dyshimeve që kanë ndodhur të një ngacmimi që beri jehon në mediat tona e kanë mundësin që përmes mediave pyetjen apo përgjigjen që i kanë institucionet e komunës tonë ta dëgjojmë përmes mediave, pa dashur ta gjykojmë si rast por ta shohim si shqetësim që prindërit i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe sivjet do të jetë edhe vajza ime. Dëshirojmë ti hekim dyshimet, të arrestohet dikush për një vepër të tillë, pra ngacmim ndaj një të miture dhe me te gjitha këto akuza të renda po lirohet brenda dite. Duam një sqarim rreth këtij rasti.

Pyetja tjetër: mullirit të Bicajt në fshatin Vrellë aty është vështirësuar puna si pasoj e rrezimit të murit që pat ndodhur me shumë se një vit, është rrezik edhe për njerëzit që e frekuentojnë atë pjesë dhe mund të kemi prape viktime tjera, kërkojmë një zgjidhje për qytetaret aty, ne e kemi pasur një bisede me drejtorin e Shërbimeve publike e falënderoj aj është i interesuar për atë pjesë aty që të rregullohet. Kur ka me filluar kjo rregullimi i asaj pjese?

Pyetja tjetër është kërkesa e prindërve që çerdhes së fëmijëve në Vrellë ti zgjatet orari i punës, për shkak se deri në 4 punojnë prindërit, kish mjaftuar që një kujdestare të rri aty deri në ora 4 e 30, vetëm 30 minuta të zgjatet orari.

Faruk Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam pyetje për z. Abedin Kabashi për punimet në qytet që po behën kur kanë me u përfundua, sepse ky ritëm me të cilin po punohet nuk po me pëlqen dhe a kemi ne ndonjë mekanizëm, a ka mundësi që deri nga gjysma e korrikut me u përfunduar, sepse vine mërgimtarët dhe duhen ato trotuare të rregullume.

Arianit Selmanaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, Kam një pyetje për Drejtorinë e Bujqësisë, me Drejtor Astrit Hajrizaj, dhe në të njëjtën kohë do të doja të shpreh shqetësimin tonë në lidhje me gjendjen e rrugës që çon drejt Bjeshkës së Kaliqanit. Rruga

aktuale është në një gjendje të rrezikshme për shkak të kthesave të forta dhe dëmtimeve të shkaktuara nga reshjet e shiut.

Ju lutem të merrni masa urgjente për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugës, duke pasur parasysh se këto kthese janë shumë të mëdha dhe paraqesin rrezik për banorët. Kërkoj që punimet të fillojnë sa më parë dhe të kryhen sa më shpejt, për të krijuar siguri të përditshme për banorët dhe për të tjerët që e përdorin atë rrugë

1. Rregullimi i kthesave të cilat janë shumë të forta.
2. Mirëmbajtja e rrugës.
3. Hapja e disa kanaleve anësore.

Ju falënderoj paraprakisht për vëmendjen tuaj ndaj kësaj çështjeje dhe shpresoj që ju të ndërmerrni hapat e nevojshëm për të adresuar këtë problem.

Arta Balaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë që për nder të jetës dhe veprës së ish kryetarit të komunës Haki Rugova kisha pasur dëshirë që një rrugë e qytetit të jetë në emër të tije, ndoshta rruga 2 Korriku ose ndonjë rrugë tjetër e qytetit ta ketë emrin e kryetarit të ndjerë.

Haki Podrimaj - kam pyetje për emërtimin e rrugëve, është bere emërtimi i shumicës së rrugëve mirë por ka ankesa nga qytetaret të cilët kanë paraqitur ankesa për ato emërtime të rrugëve, duhet tu epet një përgjigje atyre njerëzve dhe të vazhdohet.

Lavdiqe Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, e dim që në komunën ton nataliteti çdo dit e me shumë është në ramje sa ka mundësi komuna ti ndaj ka 100 euro për nenat e reja që nuk janë në mardhenje pune për dy muaj rresht. Kërkoj nga Nënkryetari le ta analizoj kërkesën.

Andi Xhuraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, tek sheshi Ibrahim Rugova pllatoja e cila gjendet në kompleksin banesor përball zyrave të KEDS ka nevojë për një renovim pasi që janë të dëmtuara pllakat dhe shkaktojnë veshtersi për banoret kish qen mirë të intervenohet pasi që sheshi i ri është ndërtuar dhe është bere një lidhje e mirë me sheshin.

Nexhmedin Balaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kanali i ujitjes për lagjen Balaj në fshatin Lluga.

- Ekzekutivi përgjigjet pyetjeve dhe jep sqarime rreth tyre.

Kryesuesi i Kuvendit

Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhëne,

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:15

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj

8

Procesverbali

